

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Trajtim dhe evadim i mbetjeve spitalore (Kukës).**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV Mbledhja, transporti dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore - **90524400-0** Mbledhja, transporti dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore

**Fondi limit i procedurës: 20,640,000** (njëzet milion e gjashtëqind e dyzet mijë) **lekë pa TVSH** ose 216,261.52 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një pikë pesëdhjetë e dy) euro pa tvsh.

Referuar kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë datë 11.05.2026 (95.44 lekë/euro).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si dhe në përputhje me legjislacionin e posaçëm për objektin e prokurimit, si më poshtë:

- Ligji nr.57/2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”
- Ligjit nr.10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar,
- VKM Nr.232 datë 01.04.2026 Për miratimin e kërkesave, procedurave dhe standardeve për menaxhimin e mbetjeve spitalore”;
- VKM nr.229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”;
- VKM nr.371, datë 11.06.2014, “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”;
- VKM Nr.402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve” (i ndryshuar);
- Urdhrit Nr.135, datë 16.4.2015 “Për miratimin e mënyrës së administrimit të formatit të regjistrit të transfertave individuale dhe të regjistrit kombëtar të transfertave, si dhe mënyrën e administrimit të tyre”

Autoriteti/enti kontraktor **“Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a”** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

*Nisur nga natyra e shërbimit që do të kryhet, si dhe duke qenë se të gjitha proceset e shërbimit, objekt prokurimi, janë të ndërvarura me njëra tjetrën nga ana funksionale dhe teknike, dhe përbëjnë një proces të integruar higjeno-sanitar, është vendosur që procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar” të mos kryhet e ndarë në lote. Gjithashtu, mosndarja në lote dhe ofrimi i shërbimit nga një operator ekonomik garantojnë një standart të qëndrueshëm të cilësisë, një nivel të unifikuar shëndetësor dhe sanitar, ndarje të saktë të përgjegjësisë, optimizim të kostos dhe ofrimi i çmimeve konkurruese, efikasitet dhe lehtësi në monitorimin dhe zbatimin e kontratës.*

Ndalohet mbeshtetja për pikat 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. 2.3 Kapaciteti Teknik pasi ky shërbim është mjaft sensitiv qofte për

mbarevajtjen e punes se spitalit qofte per shendetin e stafit mjekesor/pacienteve dhe ndikimit qe ka ne mjedis. Keto kriteret jane te domosdoshme per te krijuar bindjen se ofertuesit kane kapacitet per zbatimin e kontrates me rigorozitet sipas kushteve ligjore.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

**2.1.1** Për metoda dhe teknologji të trajtimit të përcaktuara në Ligjin Nr.10448, date 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, në Vkm Nr.232 datë 01.04.2026 Për Miratimin e kërkesave, procedurave dhe standardeve për Menaxhimin e Mbetjeve Spitalore” dhe në Termat e Referencës se DST (përveç incenerimit), ose teknologji ekuivalente, Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë:

**1.a** Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) ose të tipit B (me kod III.1.B) së bashku me Akt Miratimin përkatës,  
si dhe

**1.b** Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (*Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore*) që të përfshijnë kodet e mbetjeve të rrezikshme si më poshte:

- **18 01 01** - Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03);
- **18 01 03** - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet;

**2.1.2** Per metodën dhe teknologjinë e trajtimit ME INCENERIM, Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë:

2.a Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) së bashku me Akt Miratimin përkatës si dhe

2.b Licensën përkatëse të kategorisë III.2.B (*Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore*) ku të përfshihen kodet e mbetjeve të rrezikshme si më poshtë:

- **18 01 02** - Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03);

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe në mbështetje të pikës 5 Menaxhimi i Mbetjeve të Shtojcës 1 Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi të Ligjit Nr.10448, date 14.07.2011 ”Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar, Ligjit Nr.10431 date 09.06.2011 ”Per mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, VKM Nr.232 datë 01.04.2026 Për Miratimin e kërkesave, procedurave dhe standardeve për Menaxhimin e Mbetjeve Spitalore”, VKM Nr.402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve” i ndryshuar, Udhëzuesi Kombëtar “Për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore” dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i sigurt i Mbetjeve Spitalore”, Ligjit Nr.10081, date 23.02.2009 ”Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr.57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, dhe VKM Nr.538 date 26.05.2009 ”Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga/apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullime të tjera

nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar.

**2.1.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Akt Miratimin Higjieno –Sanitar respektiv për objektet ku ushtron aktivitetin e trajtimit të mbetjeve spitalore, të lëshuar nga ISHSH (Inspektorati Shëndetësor Shtetëror).

**Argumentimi:** Ky kriter bazohet në kërkesat e nenit 10 të Ligjit Nr.7643 datë 12.12.1992 "Për Inspektimin Sanitar" i ndryshuar, dhe në nenin 10 "Leja Mjedisore dhe Akt Miratimi Higjieno – Sanitar", të Vkm Nr.232 datë 01.04.2026 Për miratimin e kërkesave, procedurave dhe standardeve për menaxhimin e mbetjeve spitalore”, neni 11 pika 1 Dorëzuesi dhe marrësi i mbetjeve spitalore kanë detyrimin të pajisen, sipas rastit, me licencë, leje të mjedisit dhe aktmiratim higjieno-sanitar, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

**2.1.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a. Vërtetim që operatori ka kryer tarifën vjetore të Lejes Mjedisore, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në zbatim të VKM nr.417, date 25.06.2014, "Për Miratimin e Tarifave të lejeve të Mjedisit" (i ndryshuar).

b. Vërtetim që operatori nuk ka masë administrative në fuqi nga strukturat inspektuese të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në zbatim të Ligjit Nr.99/2024 "Per Inspektimin ne Republikën e Shqiperise", Ligjit "Për Lejet e Mjedisit" Nr.10448 date 14.07.2011 (i ndryshuar) si dhe Ligjit Nr.57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".

**Argumentimi:** Këto kërkesa vendosen në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Kërkesa për paraqitjen e vërtetimeve të sipërcituara sigurojnë AK operatori ekonomik kryen veprimtarinë e tij, lidhur me objektin e prokurimit në përputhje me dispozitat ligjore.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se e vlera e fondit limit. *Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuar të bilanceve, për vitet financiare (2023,2024,2025) të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Argumentim:** Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar; të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara. Vlera e kërkuar është shërben kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

**2.3.2** Operatori duhet të disponojë minimalisht 1 (një) automjet, që transportojnë mbetjet spitalore, sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës, të shërbimit objekt prokurimi.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesin dokumentet e mëposhtme provuese:

- dokumentacion për mjetin në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- Leja e qarkullimit të mjetit, Akt – kolaudimi, Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt -Miratimet Higjenosanitare, Foto të mjeteve ku të duket qartë targa dhe sinjalistika përkatëse.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset në përputhje me pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 4/ç e nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë faktin se shërbimi objekti i kësaj procedure prokurimi parashikon ndër elementet e tij edhe transportin nga AK në ambientet e trajtimit të operatorit ekonomik, si dhe te produkti final nga ambientet e operatorit drejt landfillit, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën me qëllim ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Numri i kërkuar i mjeteve është minimal referuar dhe kerkesave te AK, me qëllim që transporti i konteniereve/kontenitoreve të kryhet në mënyrë që të sigurohet integriteti dhe pastërtia e tyre, në përputhje me rregullat e higjenes dhe sigurisë, duke qenë se në specifikimet teknike dhe termat e referencës është e përcaktuar se duhet të sigurohet grumbullimi i konteniereve me mbetje ne pikat e përkohshme te magazinimit te autoriteteve shëndetësore si dhe transportin e tyre ne impiantin e trajtimit me mjetet e posaçme te transportit. Ky kriter kërkohet për të garantuar sigurinë publike dhe përmbushjen e standardeve strikte mjedisore, pasi mbetjet spitalore klasifikohen si mbetje të rrezikshme. Mbetjet spitalore paraqesin rrezik të lartë infektimi dhe kontaminimi. Kërkesa për automjete sipas specifikimeve teknike siguron që mbetjet nuk do të rrjedhin, nuk do të kenë kontakt me ajrin dhe do të mbahen në kushtet e duhura (shpesh frigoriferike ose hermetike) deri në asgjësim. Ky kriter vërteton se Operatori Ekonomik nuk është thjesht një ndërmjetës, por disponon mjetet fizike të nevojshme për të realizuar shërbimin menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, duke shmangur vonesat që mund të rrezikojnë higjienën e spitaleve.

**2.3.3** Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar, 7 (shtatë) punonjës të punësuar për realizimin e kontratës/ava që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës Përgjegjës shërbimi
- 1 (një) punonjës shofer
- 2 (dy) punonjës shërbimi (ngarkim/ shkarkim)
- 3 (tre) punonjës për operimin e impianteve dhe makinerive

Për punonjësit e kërkuar me lart, duhet të paraqiten dokumentat:

a. Për Përgjegjësin e Shërbimit:

Përgjegjësi i shërbimit duhet të jetë Inxhinier Mjedisi/Ekspert Mjedisi dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

- Diplomë me profesion Inxhinier Mjedisori/dhe/ose Certifikatë “Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor”;
- Kontratë pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi;
- formularin E-sig i listëpagesave për muajin e fundit
- b. Për punonjësit shofer
  - Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)
  - Leje Drejtimi
- c. Për punonjësit e shërbimit (ngarkim/shkarkim) dhe punonjësit për operimin e impianteve dhe makinerive të paraqitet:
  - Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)

*Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikave 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pra që kanë në dispozicion për përmbushjen e kësaj kontrate. Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, termave të referencës, proceset e realizimit të shërbimit objekt prokurimi. Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, termave të referencës, proceset e realizimit të shërbimit objekt prokurimi. Kërkesa që operatorët ekonomikë të kenë të punësuar minimalisht 7 (shtatë) punonjës për realizimin e kontratës/kontratave që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër, është vendosur në përputhje me natyrën, kompleksitetin dhe rëndësinë e shërbimit objekt prokurimi, i cili lidhet me grumbullimin, transportin, trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme. Ky shërbim kërkon organizim të specializuar operacional, garantim të vijimësisë së procesit të punës, respektim të standardeve të sigurisë teknike dhe mjedisore, si dhe zbatim të procedurave specifike për menaxhimin e mbetjeve me risk biologjik dhe infektiv. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar të nevojshme disponimin e një stafi minimal teknik dhe operacional, të ndarë sipas funksioneve konkrete të nevojshme për realizimin korrekt dhe të pandërprerë të kontratës.

Përgjegjësi i shërbimit nevojitet për organizimin, drejtimin, ndarjen dhe mbikëqyrjen e proceseve të shërbimit, si dhe përgjigjet për zbatimin e të gjitha detyrave dhe fazave të shërbimit, në përputhje me specifikimet teknike, termat e referencës, rregullat dhe standartet ligjore të zbatueshme në fuqi. Profili i kërkuar për përgjegjësin e shërbimit lidhet me faktin se një inxhinier mjedis/ekspert mjedis ka ekspertizën e duhur për të analizuar ndikimet e ndryshme që mund të sjellë trajtimi i mbetjeve të rrezikshme në mjedis, duke përfshirë ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës. Inxhinieri i mjedisit luan një rol kryesor në implementimin e standarteve mjedisore, monitorimin e emetimeve dhe kontrollit të ndotjes, si dhe në planifikimin e mergjencave mjedisore që mund të ndodhin.

Nisur nga analizimi i specifikimeve teknike dhe termave të referencës, si dhe duke vlerësuar se ndër proceset e punës është edhe grumbullimi i koshave/ kontenierëve/ kontenitorë me mbetje në pikat e përkohshme të magazinimit të autoriteteve shëndetësore, ngarkimin dhe shkarkimin e koshave/ kontenierëve/ kontenitorë dhe nga makina e grumbullimit janë kërkuar 2 punëtorë ndihmës pasi për mbajtjen e kontenierëve /kontenitoreve duhen minimalisht 2 punonjës theksojme se sasia e mbetjeve që do të terhiqen nga ambientet spitalore mund të kenë peshe të konsiderueshme në varesi të mbetjeve që gjenerohen nga aktiviteti spitalor. Dy punonjësit e shërbimit për ngarkim/shkarkim janë kërkuar për të garantuar manipulimin e sigurt të mbetjeve gjatë procesit të marrjes, lëvizjes dhe dorëzimit të tyre, duke minimizuar rrezikun e ekspozimit, kontaminimit dhe aksidenteve gjatë punës.

Punonjësi “Shofer” është i domosdoshëm për realizimin e transportit të mbetjeve spitalore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e sigurisë për transportin e mbetjeve të rrezikshme.

Numri 3 i punonjësve për operimin e impianteve dhe makinerive që do të përdoren është vlerësuar i tillë në përputhje me 3 impjantet e kërkuar *impiant back up për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) impiant back up për asgjësimin me incenerim makineri back up për larjen e kontenierëve (vetëm në rastin kur do të përdoren konteniere të ripërdorshem)*, si dhe proceset e punës dhe detyrat që do të kryhen. Keto procese janë shumë të rëndësishme për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi ku bëhet fjalë për mbetje të rrezikshme spitalore ku kërkohet staf për përdorimin e tyre me qëllim mbarevajtjen e shërbimit dhe duke ruajtur standardet mjedisore. Tre punonjësit për operimin e impianteve dhe makinerive janë të nevojshëm për funksionimin e vazhdueshëm dhe të sigurt të impianteve të sterilizimit/incenerimit dhe makinerive ndihmëse, duke marrë në konsideratë proceset teknike që kërkojnë monitorim të vazhdueshëm, ndarje të turneve të punës dhe reagim të menjëhershëm në rast problematikash teknike apo emergjencash operacionale.

Numri i kërkuar i punonjësve është përcaktuar në raport të drejtë dhe proporcional me volumin e shërbimit, natyrën sensitive të mbetjeve spitalore dhe nevojën për garantimin e vijimësisë së pandërprerë të shërbimit, pa krijuar barriera të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë. Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor synon të sigurojë që operatori ekonomik fitues disponon burimet njerëzore minimale të nevojshme për të realizuar kontratën në mënyrë efektive, të sigurt dhe në përputhje me kërkesat teknike, sanitare dhe mjedisore në fuqi. Numri i punonjësve është minimal dhe vlerësuar i tillë në përputhje me proceset e punës dhe detyrat që do të kryhen, në përputhje me specifikimet teknike dhe termat e referencës. Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

**2.3.4.** Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/përdorim, apo nëpërmjet çdo mënyre posedimi të njohur nga ligji, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt prokurimi, sipas Ligjit Nr.57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, si dhe Vkm Nr.232 datë 01.04.2026 Për Miratimin e kërkesave, procedurave dhe standardeve për Menaxhimin e Mbetjeve Spitalore si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

- a. Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - cope 1
- b. Impiant për asgjësimin me incenerim - cope 1
- c. Makineri për larjen e kontenierëve cope 1

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentet e mëposhtme provuese:

- a. Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/përdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);
- b. Të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;
- c. Katalog ose skede teknike ose çdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë;
- d. Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë.

**Shënim:** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e të dhënave konkrete për secilën pajisje (përfshirë edhe ato back up), nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST, duke përfshirë të dhënat si vijon: emërtimi i impiantit / përcaktimi si primar apo back up / modeli / rrymat e mbetjeve që trajton dhe/ose asgjëson / Leja dhe Licenca përkatëse ku janë të përfshirë (nga ato të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër.

Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Në bazë të Ligjit Nr.57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Ligjit nr.10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, Vkm Nr.232 datë 01.04.2026 Për Miratimin e kërkesave, procedurave dhe standardeve për Menaxhimin e Mbetjeve Spitalore”, VKM Nr.402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve” i ndryshuar, impiantet për realizimin e trajtimit të kategorive të caktuara të mbetjeve spitalore, janë pajisjet baze për realizimin me sukses të këtij shërbimi.

Pasqyrimi në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 vërtetojnë se këto pajisje janë të licencuara për realizimin e procesit të trajtimit të mbetjeve nga organi kompetent. Ky certifikim është detyrim ligjor për të gjitha pajisjet të cilat kryejnë këto lloj procesesh në territorin e RSH dhe jo për pronarin apo personin e trete, ndaj kërkesa është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit në fjalë. Fokusi i kësaj kërkesë është tek impianti dhe jo tek personat e trete të cilët japin me qera apo huapërdorje.

Katalog ose skede teknike ose çdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë, si dhe Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë provon përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike të kërkuara.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë: kontratë të lidhur me një subjekt të lejuar nga AKM për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jete aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie me kodin 19 01 dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me sterilizim me kodin 19 03.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në VKM Nr.402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, si dhe duke qene se në baze të Vkm Nr.232 Datë 01.04.2026 Për Miratimin e kërkesave, procedurave dhe standardeve për Menaxhimin e Mbetjeve Spitalore”, strukturat spitalore si krijues të mbetjeve janë përgjegjës deri në hallkën e fundit të asgjësimit të mbetjeve spitalore që krijojnë, AK kërkon që operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë të lidhur me subjekt të autorizuar sipas ligjit për depozitimin e produktit final respektiv që del nga proceset e trajtimit/asgjësimit, e cila duhet të jete aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave dhe në vazhdimësi të kësaj marrëveshje deri në përfundim të kontratës së realizimit të kontratës.

Këto dokumente kërkohen me qëllim realizimin me sukses të asgjësimit final të mbetjeve si element mjaft i rëndësishëm i procesit ku dokumentohet që OE është në këtë fushë aktiviteti dhe e kryen këtë lloj shërbimi.

**2.3.6** Operatori duhet të paraqesë për **kontenierë/ kontenitorë** sipas standardeve dhe kërkesave të Specifikimeve Teknike dhe Termave të Referencës:

- Katalog ose skede teknike,
- Vetëdeklarim për certifikim dhe aprovim të tipit të ambalazhit për secilin lloj kontenitori (i

ri-përdorshëm ose njëpërdorimësh) referuar VKM Nr.232 datë 01.04.2026 Për Miratimin e Kërkesave, Procedurave dhe Standardeve për Menaxhimin e Mbetjeve Spitalore.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 4/ç nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet dhe pajisjet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Në bazë të Ligjit Nr.57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Ligjit nr.10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, Vkm Nr.232 datë 01.04.2026 Për Miratimin e kërkesave, procedurave dhe standardeve për Menaxhimin e Mbetjeve Spitalore”, VKM Nr.402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, i ndryshuar kontenitorët e mbetjeve spitalore janë elemente të domosdoshëm në proceset e menaxhimit të evadimit të mbetjeve spitalore si për mbledhjen, izolimin, grumbullimin, dhe transportimin e tyre.

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë (të vlefshme dhe në përputhje me objektin e prokurimit), si më poshtë:

- SSH UNI DIN EN ISO 14001 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH UNI DIN EN ISO 9001 “Sisteme të menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente/të barazvlefshme;
- SSH UNI DIN EN ISO 45001 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/të barazvlefshme.

*Çertifikatat përkatëse, duhet të jenë të lëshuara nga organet e vlerësimit të konformitetit, të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, dhe të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Standarti 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm pasi siguron se operatori ekonomik ka një sistem të strukturuar menaxhimi për cilësinë e vazhdueshme të shërbimit objekt prokurimi. Pajisja me këtë standart garanton që proceset e realizimit të shërbimit do të kryhen në mënyrë të kontrolluar, të dokumentuar, duke minimizuar gabimet/neglizhencat gjatë trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve.

-Standarti 14001 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” – është vendosur si kriter duke marrë në konsideratë faktin që ky Standardi është një sistem sistematik dhe i orientuar drejt procesit të menaxhimit të cilësisë për të kontrolluar impaktet e rëndësishme të aktiviteteve të biznesit në mjedis, si dhe duke vlerësuar se objekti i prokurimit përfshin grumbullimin, trajtimin, transportimin, asgjësimin e mbetjeve spitalore. Pajisja e operatorit ekonomik me këtë standart është një tregues se ofertuesi është i aftë të identifikojë, kontrollojë dhe minimizojë ndikimin e tij në mjedis gjatë realizimit të shërbimeve objekt prokurimi.

-Standarti 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen shërbimin në përputhje me standartet e kërkuara sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë. Është një tregues që operatori mbron punonjësit nga rreziqet biologjike, kimike dhe fizike që lidhen me trajtimin e mbetjeve të rrezikshme, si dhe siguron trajnime, pajisje mbrojtëse, protokolle sigurie dhe masa prandaluese për aksidente që mund të ndodhin gjatë realizimit të shërbimeve.

**2.3.8** Operatori ekonomik me anë të një deklaratë duhet të deklarojë se merr përsipër të furnizojë me amballazhe, kuti, qeskat, etj, si dhe çdo gjë tjetër sipas specifikimeve teknike.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 4/ç nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të furnizojnë me materialet e kerkuara me lart si dhe cdo specifikim tjetër i kerkuar nga AK perfituese me qëllim zbatimin me sukses të kontratës pasi janë elemente të domosdoshëm në proceset e menaxhimit të mbetjeve spitalore.

2.3.9 Operatori ekonomik me anë të një deklarate duhet të deklarojë se pas marrjes në dorëzim të mbetjeve, nga ambientet e AK, do të bëjë dezinfektimin e kontenierë/ kontenitorë/ kosha si dhe ambientit nga ku do të tërhiqen mbetjet e rrezikshme spitalore të kontaminuara.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr.162/2020, “Për prokurimin publik” dhe pikës 4/ç nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të marrin persiper të dizefektojnë ambientet duke ruajtur dhe respektuar kushtet higjeno-sanitare pas procesit të largimit të mbetjeve për të minimizuar bakteret apo infeksionet që mund të shkaktohen nga to.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike/termat e referencës si dhe perlllogaritja e **Fondit Limit** për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, janë të hartuara nga AK përfitues **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës, të cilat janë percjelle prane OBP** dhe janë bërë pjesë e pandashme e dosjes së prokurimit, pasi janë struktura që disponon njohuritë teknike, operacionale dhe funksionale mbi nevojat konkrete të shërbimit që kërkohet të prokurohet. Hartimi i tyre nga institucioni kërkues bazohet në faktin se ky institucion është përdoruesi i drejtpërdrejtë i shërbimit dhe, për rrjedhojë, është struktura që vlerëson nevojat reale, volumet, kërkesat teknike, standardet e sigurisë dhe mënyrën e realizimit të shërbimit në funksion të aktivitetit spitalor. Ndersa OBP që zhvillon procedurën e prokurimit ushtron përgjegjësinë për administrimin e procedurës në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, duke hartuar dhe vendosur kriteret e kualifikimit, kriteret e vlerësimit dhe kërkesat ligjore/procedurale që lidhen me aftësinë ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës”, Për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar, ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku neni 36 dhe nenet 77–79 parashikojnë që autoriteti kontraktor (në këtë rast AK përfituese Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës duhet të përcaktojë specifikime teknike që sigurojnë realizimin e kontratës në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, nenet 39–44 parashikojnë që kriteret teknike dhe profesionale duhet të jenë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me natyrën e saj dhe legjislacionin mjedisor dhe shëndetësor në fuqi, i cili detyron subjektet që gjenerojnë mbetje të rrezikshme t’i trajtojnë ato përmes operatorëve të licencuar dhe me leje mjedisore përkatëse.

## **Argumentimi i kriterit ekonomikisht më e favorshme**

### **4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

#### **A)<sup>1</sup> Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X**

---

<sup>1</sup> Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës

Sipas rëndësisë:

- |   |                 |
|---|-----------------|
| <b>1. Çmimi</b>   | <b>pikët 70</b> |
| <b>2. Teknologjia</b>                                       | <b>pikët 15</b> |
| <b>3. Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit</b> | <b>pikët 15</b> |

**Shpërndarja e pikëve si më poshtë:**

**Kriteri:**

1. **Çmimi:** **70 pikë**

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

**Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:**

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmax1 / Ok1$$

Ok1 \_\_\_\_\_ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 \_\_\_\_\_ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmax1 \_\_\_\_\_ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 \_\_\_\_\_ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

2. **Teknologjia:** **[0- 15] pikë e ndarë si më poshtë:**

- a. impiant back up për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) – [0- 5] pikë
- b. impiant back up për asgjësimin me incenerim – [0- 5] pikë
- c. makineri back up për larjen e kontenierëve (vetëm në rastin kur do të përdoren konteniere të ripërdorshme) – [0- 5] pikë

Në bazë të Ligjit Nr.57/2025 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, Ligjit nr.10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, VKM Nr.232 Datë 01.04.2026 Për Miratimin e Kërkesave, Procedurave dhe Standardeve për Menaxhimin e Mbetjeve Spitalore’, VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, në pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit janë kërkuar: Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente), Impiant për asgjësimin me incenerim, Makineri për larjen e kontenierëve, si impiante/makineri bazë për realizimin me sukses shërbimit objekt prokurimi.

Duke mbajtur në konsideratë, se impiantet kanë nevojë edhe për periudha mirëmbajtjeje parandaluese ose/dhe korrigjuese, si dhe duke parashikuar që mund të pësojnë difekte të zgjatura në kohë ose edhe të pariparueshme, është vlerësuar e nevojshme edhe një makineri back up ose zëvendësuese, për secilin impiant/makineri me të njëjtin kapacitet, në mënyrë që të mos rrezikohet ndërprerja e shërbimit. Kjo edhe sepse, edhe në rast se OE do të zëvendësohte impiantin e difektuar me një të ri, do të merrte sidoqoftë një kohë të gjatë pajisja e tyre me lejet e licencat përkatëse, çfarë sërish do të shkaktonte ndërprerje të shërbimit.

Njëkohësisht, impianti back up i sipërkërkuar lidhet me ndikim në mjedis, pasi nëse mungon ky impiaat dhe ndodh avari, mbetjet mund të qëndrojnë të pamënaxhuara, çfarë do të rriste rrezikun për ndotje të ajrit, ujit dhe tokës, mund të çojë në ruajtje jo të sigurtë të mbetjeve në ambiente spitalore ose tranzitore, apo mund të sjellë përdorimin e mënyrave jo të autorizuara për eliminimin.

Për të plotësuar këtë kërkesë, ofertuesit duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

---

*fituese do të jetë “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.*

**Për nënkriterin a) zbatohet formula si më poshtë:**

$$Pk2(a) = Ok2(a) \times Pmaxk2(a) / Vmaxk(a)$$

Vmaxk2(a) \_\_\_\_\_ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

Pmaxk2(a) \_\_\_\_\_ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok2(a) \_\_\_\_\_ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

**Për nënkriterin b) zbatohet formula si më poshtë:**

$$Pk2(b) = Ok2(b) \times Pmaxk2(b) / Vmaxk(b)$$

Vmaxk2(b) \_\_\_\_\_ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

Pmaxk2(b) \_\_\_\_\_ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok2(b) \_\_\_\_\_ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

**Për nënkriterin c) zbatohet formula si më poshtë:**

$$Pk2(c) = Ok2(c) \times Pmaxk2(c) / Vmaxk(c)$$

Vmaxk2(c) \_\_\_\_\_ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

Pmaxk2(c) \_\_\_\_\_ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok2(c) \_\_\_\_\_ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

**3. Metodologjia:**

**[0-15]** pikë, e ndarë si më poshtë:

**a. Masat dhe praktikave të menaxhimit mjedisor/përfshirë trajnimin e stafit – [0-10] pikë**

Sistemi i menaxhimit mjedisor është një sistem thelbësor në procedurën objekt prokurimi, pasi trajtimi, grumbullimi dhe asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore, kanë ndikim potencial në mjedis. Vlerësimi i masave dhe praktikave të menaxhimit mjedisor realizohet nëpërmjet kombinimit të monitorimeve teknike, regjistrimit të treguesve operacionale, mjedisor, trajnimit të stafit dhe planifikimit të emergjencave, që së bashku garantojnë një ekzekutim të sigurtë përputhje me standartet ligjore mjedisore.

Ofertuesi duhet të ketë procedura operacionale të cilat do të zbatohen gjatë ekzekutimit të kontratës, (por pa u kufizuar në to) si: minimizimi i emetimeve të dëmshme, uljen e ndotjes, minimizimin e ndikimit mjedisor gjatë trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve, kontrolli i zhurmës, përdorimi dhe riciklimi i ujit në procesin e larjes, trajnimi i stafit lidhur me treguesit e menaxhimit mjedisor.

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument të shkruar, ku të përfshihen përcaktimet e mësipërme, por pa u kufizuar në to.

**b. Planveprimi për ekzekutimin e kontratës**

**[0-5]** pikë

Kërkesa për planveprimin e ekzekutimit të kontratës është një dokument kryesor në zbatimin e kontratës, veçanërisht në sektorin e menaxhimit mjedisor, për disa arsye:

Siguria dhe përputhshmëria me standarde mjedisore: Planveprimi parashikon masat për të siguruar që aktivitetet operacionale të kryhen në përputhje me kërkesat ligjore dhe normat mjedisore, duke ndihmuar në minimizimin e ndikimeve negative në mjedis dhe garanton që të gjitha procedurat janë të strukturuar dhe të kontrolluara. Koordinimi dhe efikasiteti operacionale: Planveprimi përcakton qartë afatet kohore, burimet e nevojshme dhe përgjegjësitë përkatëse, duke krijuar koordinimin efektiv ndërmjet palëve dhe parandalon vonesta apo ndërprerjet që mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimit.

Monitorimi dhe kontrolli i performancës: Përmes planveprimit krijohet një kornizë e qartë për monitorimin e vazhdueshëm të performancës. Raportimet periodike dhe auditimet e parashikuara lejojnë identifikimin e devijimeve nga plani kryesor dhe marrjen e masave korriguese në kohë reale. Menaxhimi i emergjencave: planveprimi parashikon gjithashtu edhe procedurat e detajuara në rast se ndodh një defekt teknik, mbingarkesë apo incident që ndikon në cilësinë e shërbimit. Të gjitha sa më

sipër, por pa u kufizuar në to, siguron AK për aftësinë e operatorit ekonomik për të përmbushur kërkesat kontraktuale, sipas specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara.

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument të shkruar, ku të përfshihen përcaktimet e mësipërme, por pa u kufizuar në to.

**Për nënkriterin a) zbatohet formula si më poshtë:**

$Pk3(a) = Ok3(a) \times Pmax3(a) / Vmax k(a)$

$Vmax3(a)$  \_\_\_\_\_ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$Pmax3(a)$  \_\_\_\_\_ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok3(a)$  \_\_\_\_\_ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

**Për nënkriterin b) zbatohet formula si më poshtë:**

$Pk3(b) = Ok3(b) \times Pmax3(b) / Vmax k(b)$

$Vmax3(b)$  \_\_\_\_\_ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$Pmax3(b)$  \_\_\_\_\_ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok3(b)$  \_\_\_\_\_ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

*Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave janë vendosur duke mbajtur në konsideratë ligjin Nr 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Ligjit nr.10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, VKM Nr.232 Datë 01.04.2026 Për Miratimin e Kërkesave, Procedurave dhe Standardeve për Menaxhimin e Mbetjeve Spitalore’, VKM Nr.402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”. Duke mbajtur në konsideratë që ky është një shërbim shumë sensitiv dhe me ndikim në shëndetin e pacienteve/stafit si dhe ndikim në mjedis. Është e rëndësishme që operatori ekonomik i cili do të merret me menaxhimin trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme të ketë impjantet e kërkuara për realizimin e kontratës objekt prokurimi pasi kur mbetjet qëndrojnë të pamënaxhuara, do të rrishte rrezikun për ndotje të ajrit, ujit dhe tokës, Pra për këtë arsye i është dhënë rëndësi vlerësimi në kosto si dhe në të gjitha ndarjet dhe nendarjet për secilin kriter është sqaruar dhe argumentuar pesha e secilit kriter dhe rëndësia e tij.*

Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kriter për përzgjedhjen e fituesit “ofertën ekonomikisht më të favorshme, bazuar në kosto”, duke kombinuar elementin ekonomik me elementët teknikë dhe metodologjikë, me qëllim garantimin e realizimit të sigurt, të pandërprerë dhe në përputhje me standardet ligjore e mjedisore të shërbimit objekt prokurimi.

Objekti i kësaj procedure lidhet me trajtimin, transportin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme, shërbim i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin publik, sigurinë sanitare dhe mbrojtjen e mjedisit. Për këtë arsye, përzgjedhja e operatorit ekonomik nuk mund të mbështetet vetëm në kriterin e çmimit më të ulët, pasi një ofertë me kosto minimale nuk garanton domosdoshmërisht kapacitetet teknike, vazhdimësinë operacionale dhe standardet mjedisore të kërkuara për realizimin me sukses të kontratës.

Në këtë kuadër, shpërndarja e pikëve është bërë në mënyrë proporcionale dhe të balancuar, duke i dhënë peshën kryesore elementit ekonomik (70 pikë), por njëkohësisht duke vlerësuar edhe elementët cilësorë dhe teknikë që ndikojnë drejtpërdrejt në performancën dhe sigurinë e shërbimit.

Kriteri “Teknologjia” është vlerësuar me 15 pikë, pasi ekzistenca e impianteve dhe makinerive back up për sterilizim, incenerim dhe larje kontenierësh garanton vijimësinë e pandërprerë të shërbimit edhe në rast avarish, mirëmbajtjeje apo situatash emergjente. Duke qenë se mbetjet spitalore paraqesin rrezik të lartë biologjik dhe mjedisor, mungesa e kapaciteteve rezervë mund të shkaktojë ndërprerje të shërbimit, depozitim të pasigurt të mbetjeve dhe rritje të rrezikut për ndotje të ajrit, ujit

dhe tokës. Për rrjedhojë, vlerësimi i teknologjisë rezervë konsiderohet element thelbësor për garantimin e sigurisë operacionale dhe mbrojtjes së mjedisit.

Ndërkohë, kriteri “Metodologjia” është vlerësuar me 15 pikë, pasi mënyra e organizimit dhe realizimit të shërbimit ndikon drejtpërdrejt në cilësinë dhe efikasitetin e ekzekutimit të kontratës. Masat dhe praktikrat e menaxhimit mjedisor, përfshirë trajnimet e stafit, procedurat operacionale dhe menaxhimin e emergjencave, garantojnë përputhshmërinë me legjislacionin mjedisor dhe standardet teknike në fuqi. Gjithashtu, planveprimi për ekzekutimin e kontratës siguron koordinim operacional, monitorim të performancës dhe reagim në kohë ndaj çdo situatë që mund të ndikojë në cilësinë e shërbimit.

Përdorimi i formulave matematikore për vlerësimin e secilit kriter dhe nënkriter siguron transparencë, proporcionalitet, objektivitet dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë, duke bërë të mundur identifikimin e ofertës që ofron raportin më të mirë ndërmjet koston dhe cilësisë.

A.K vlerëson se përdorimi i kriterit “Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto” është në përputhje me natyrën dhe rëndësinë e shërbimit objekt prokurimi, si dhe garanton përzgjedhjen e operatorit ekonomik që ofron jo vetëm ofertën ekonomike më konkurruese, por edhe sigurinë teknike, qëndrueshmërinë operacionale dhe standardet e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit publik dhe mjedisit.